Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/174 Nr. i faq/Br.str/No.pg 91
Data/Datum/Date 31 / 08 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2011")*, nenit 12 paragrafi 1 pika 1.6 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2026 miraton këtë:

V E N D I M
Për miratimin e Raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

1. **MIRATOHET** Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Rahovecit nga vërshimet e datës 21 dhe 27 korrik të vitit 2026.

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Rahovecit nga vërshimet e datës 21 dhe 27 korrik të vitit 2026 me Nr. Prot. 02/3279 i datës 25.08.2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës

Vendimi u dërgohet:
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Komisionit Qeveritar për Vlerësim të Dëmëve nga fatkeqësit natyrore dhe Fatkeqësit e tjera,***
- ***Agjencisë për Menaxhimin Emergjent,***
- ***Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01-Nr. 174/26
Datë: 31.08.2026

Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit